

PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 31.08.2023

Kryesuesi i mbledhjes është Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi

Ora e hapjes së mbledhjes: 10:00

Zhvillimi i mbledhjes: në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 26

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej këshilltarësh: 26

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: 1

Të pranishëm në mbledhje qytetarë:

Pika 1 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Besoj secili nga ju e ka lexuar rendin e ditës, unë nuk po i citoj të gjitha pikat.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Pika 2 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 27- KORRIK 2023.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka në lidhje me këtë procesverbal ?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 3 e rendit të ditës

MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1 – 31 KORRIK 2023.

Këshilltare A.Taho: Komisioni i Mirëqënies është mbledhur ditën e hënë dhe në pjesëmarrje vetëm të opozitës ka miratuar dhe kërkohet që ti kalohet për miratim këshillit bashkiak, për 63 familje për këtë muaj.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje diskutim?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 4 e rendit të ditës.

MBI MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QERASË PËR FAMILJET E PASTREHA.

Këshilltare A.Taho: 4 familjet që kanë aplikuar kanë plotësuar kushtet, janë përzgjedhur sipas drejtorisë përkatëse. Komisioni i kërkon këshillit ta kalojë për votim edhe këtë çështje.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka ndonjë pyetje nga këshilltarët?

Këshilltar K.Pllaha: Kanë qënë vetëm këto 4 familje që kanë aplikuar, ose sa ka qënë numri total i aplikimeve?

Ekzekutivi M.Balli: Këto 4 familje që i propozohen këshillit bashkiak për ta miratuar me vendim, janë familje që i plotësojnë kushtet. Numri i familjeve që kanë aplikuar apo që aplikojnë çdo vit është më i madh, por janë në pritje të plotësimit të dokumentacionit dhe të shqyrtimit të tyre. Aktualisht mund të jenë 3-4 familje të tjera.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 5 e rendit të ditës.

MBI MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË GRANTIN E MENJËHERSHËM NË BANESAT ME KOSTO TË ULËT NGA BUXHETI I SHTETIT.

Këshilltare A.Taho: Edhe në këtë 3 aplikime janë miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe komisioni i kërkon këshillit ta kalojë për votim.

Ekzekutivi M.Balli: Këta 3 emra që ju propozuan këshillit bashkiak për të bërë miratimin janë 3 emra që kanë aplikuar dhe mbështeten me fonde nga buxheti i shtetit për vitin 2023. Ky nuk është

një projekt, është një nga instrumentat financiare që sipas ligjit për strehimin ndihmojnë familjet që plotësojnë kushtet në uljen e detyrimit në masën 10%. Ka familje të tjera që kanë aplikuar, numri për këtë vit është i lartë duke respektuar afatet që përcakton ligji për këtë program ato do të shqyrtohen nga Drejtoria për Strehimin Social, do ti kërkohet drejtorisë së Strehimit pranë Ministrisë së Financave të bëjë vlerësimin dhe më pas do të shikohet se cilët do të jenë ata që do të përfitojnë grantin e menjëhershëm i cili do të mbështetet në vitin 2024 me fondet e buxhetit të vitit 2024.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 6 e rendit të ditës.

PËR PËRCAKTIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR ZNJ.ZARIFE ILJAZI, TË CILËS I ËSHTË DËMTUAR BANESA NGA RËNIA E ZJARRIT.

Këshilltar A.Habip: Përsa i përket komisionit të financave meqënëse në datën 28 Gusht nuk u arrit korrumi për shkak sepse ishin prezent vetëm këshilltarët Ada Përmeti dhe Altin Habip nuk mundi që të shqyrtohet.

Kryetari i Këshillit A.Verushi : Nga Komisioni i Emergjencave Civile ka diçka?

Këshilltar L.Malaveci: Ditën e hënë u mbledh komisioni i emergjencave civile së bashku me 3 anëtarë unë Marsela Ciromarin dhe Dorina Qyteza dhe vendosëm t'ja kalonim këshillit për miratim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kjo është një procedurë, është përcaktuar vlera e masës së dëmtimit, kalon në komisionin e këshillit të qarkut me vendimarrje dhe kthehet në këshillin bashkiak për të marrë një vendim për shpërblimin ndaj zonjës që i janë djegur orenditë shtëpiake. Ka diçka tjetër?

Këshilltare L.Alidinaj :Dua të theksoj këtu nga financa sa është kjo vlera që do marrë kjo zonja dhe e dyta ka raste të tjera të trajtuar me ndihmë?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po të ketë raste paraqiten pranë ekzekutivit dhe më pas bëhet vlerësimi nga ekspertët. Deri tani është vetëm kjo zonjë.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 29

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 7 e rendit të ditës.

(SIPAS KËRKESËS TË QËNDRA SPORTIVE KORÇË SH.A) PËR SHQYRTIMIN E MATERIALIT SI MË POSHTË:

- “PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMI NR.19 DATË 25.01.2023 PËR MIRATIMIN E TRAJTIMIT USHQIMOR DHE DIETAVE PËR EKIPIN E PARË DHE AKADEMINË SKËNDERBEU PËR VITIN 2023”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi : Edhe njëherë komisioni i financave i cili nuk është mbledhur po ndonjë opinion nëse e keni lexuar materialin si këshilltarë.

Këshilltar A.Habip : Edhe unë edhe Ada Përmeti e kemi lexuar projekt vendimin dhe ne jemi dakord pavarësisht se nuk arritëm të mbledhjet korrumi, por jemi dakord për kalimin e fondit shtesë për trajtimin e futbollistëve.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ndonjë pyetje ka? Keni të drejtë si këshilltarë ta shqyrtoni materialin dhe të jepni mendimin tuaj.

Këshilltar L.Petri: Komisioni nuk është mbledhur ndaj nuk jam dakord.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Mund të bëni pyetje këtu dhe mund të sqaroheni. Gjithësesi është vullneti juaj i lirë.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 2

Vota ABSTENIM 1

Pika 8 e rendit të ditës.

“MIRATIMIN PËR VËNIEN NË DISPOZICION TË PROJEKTIT, SIPAS VKM-SË NR.17, DATË 18.1.2023, PËR ZHVILLIMIN E PRONËS ME NR. PASURIE 1/5, ZONA KADASTRALE 8561, E LLOJIT “TERREN SPORTIV”, ME SIP 23934.7 M2; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/12, ZONA KADASTRALE 8561, E LLOJIT “TRUALL”, ME SIP. 2974.5 M2; TË PRONËS ME NR. PASURIE 1/912, ZONA KADASTRALE 8561, E LLOJIT “TRUALL”, ME SIP 85836 M2; NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË DHE MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR ZHVILLIMIN E PROJEKTIT TË ZONËS MULTIFUNKSIONALE PËRRETH KOMPLEKSIT TË STADIUMIT “SKËNDERBEU” NË KORÇË, PËRFSHIRË STADIUMIN, QË DO TË NËNSHKRUHET MIDIS MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT, BASHKISË KORÇË, AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT SI DHE FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT”.

Këshilltar K.Koçibelli : Komisioni i cili u mbledh ditën e hënë pasi u njoh me relacionin dhe projektvendimin duke pasur parasysh edhe VKM duke pasur parasysh edhe projektin fitues ka vendosur që ti kalojë KBK për miratim këtë relacion.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka ndonjë pyetje nga këshilltarët?

Këshilltar E.Bregu: Kam kërkuar zyrtarisht nëpërmjet email-it që të komunikojnë që të paraqitin dokumentacion shtesë sepse nuk ka asnjë lloj dokumentacioni të qartë. Projekti nuk është paraqitur, nuk është as projekti teknik, nuk ka asnjë lloj vlere të përcaktuar të kostos së investimit

nuk ka asnjë analizë se çfarë përfiton komuniteti i bashkisë Korçë nga ky zhvillim prone , kur bëhet fjalë që e gjithë sipërfaqja e truallit atje është pronë e bashkisë Korçë përpara se të hidhet në votim, se çfarë po votojmë? Po votojmë si robota automatikisht pa pasur asnjë informacion. Për këtë arsye isha kundër rendit të ditës që në fillim, ndaj kërkoj që kjo pikë të shtyhet në mbledhjen e rradhës duke sjellë informacionin e kërkuar.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ky është mendimi juaj, pyetje nga këshilltarët ka?

Këshilltar L.Petri: Unë do e shtroj në formë komenti dhe jo pyetje sepse mendoj që po ndodh një tjetërsim prone dhe unë dje jam takuar me një nga disa trashëgimtarët që janë pronarë të një pjese të terrenit të stadiumit, është familja Bezhani. Sikundër tyre dhe me një familje tjetër me të cilët kam folur nëpërmjet komunikimit online pasi ndodhet ne SHBA , po ashtu është familja Shugari dhe Terezi. Unë e kuptoj që ne edhe këtu ku ndodhemi jemi në një farë shkeljeje sepse po e mbledhim këshillin bashkiak në një territor ku ka qënë kisha ortodokse që është ndërtuar me ndihmën e Filantropit dhe Lakçe dhe jemi në një shkelje këtu njëherë dhe tani po shtrohet për miratim një shkelje tjetër që po ndodh për një projekt.

Këshilltar K.Pllaha: Problemi që unë do shtroja tek ky lloj investimi janë dy në fakt.Ky është një investim që do ndryshojë dhe urbanistikën e Korçë dhe shpresoj që do të qëndrojë ndoshta për 100 vitet e ardhshme, kështu që kemi një çështje që nuk mjafton të kalohet me një pikë rend dite, pa kaluar më parë një diskutim të gjatë publik dhe çështja kryesore që ngre është për projektin fitues nuk ka pasur një diskutim publik me qytetarët dhe me grupet e interesit . Për shembull një problematikë që është ngritur nga grupet e interesit është fakti që projekti nuk përmban një pistë olimpikë. Mesa pashë në marrëveshja e bashkëpunimit që bashkia do të nënshkruajë mundësinë që të japë sugjerime për përmirësimin e projektit unë do të bëja këtë kërkesë që të shtrojë një mundësi për konsultim publik me qytetarët dhe grupet e interesit përpara se të kalonte në rendin e ditës dhe përpara se të hynte në votim. Dhe e dyta është një problematikë me ish pronarët e pronës që ndahen në dy kategori.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem dëgjoni mendimin për pyetjet që bëni pastaj vazhdoni.

Këshilltar K.Pllaha: Nuk është çështje mendimi.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Është në formën e diskutimit.

Këshilltar E.Fejzulla: Doja të dija më shumë në pjesën e pas miratimit të këtij materiali a do të ketë një proces tjetër votimi në lidhje me zhvillimin që do të marrë kjo zonë apo ne e japim miratimin sot dhe mbyllet si proces dhe ne nuk jemi në dijeni të zhvillimit që do të ndodhë në atë zonë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Tani ne e kuptojmë nga mënyra si i ndërtoni pyetjet, ka qënë kostant s'ka qënë konstat, ka qënë në fushën e duhur apo jo. Tani të lutem pyetjet

Këshilltar L.Petri: Pyetja ime është kjo përse tani që po i kaloka privatit për tu zhvilluar nuk shpronësohen së pari pronarët dhe pastaj të disktohet të kalohet për çështje strategjike.

Këshilltare L.Alidinaj: Pyetja e parë kjo pronë do kalojë nga bashkia ? Pra do ngelet pronë e Bashkisë Korçë? Dhe pyetja e dytë efekti financiar që i kushton buxhetit të bashkisë sa është?

Kryetari i bashkisë S.Filo: Kjo është pika që besoj se ka më tepër interes nga këshilltarët pasi bëhet fjalë për një projekt madhor i bashkisë me suportin e qeverisë Shqiptare . Eshtë një prej 5-6

projekteve që do të jenë kryefjala e punës të bashkisë gjatë këtij mandati dhe jamë shumë i kënaqur që me këtë projekt jemi duke ecur me shpejtësi. Tani do t'ju lutesha shumë këshilltarëve që për cdo pikë të rendit të ditës të kësaj mbledhjeje apo të mbledhjeve në vazhdim minimalisht lexojini materialet dhe përpiquni të kuptoni se çfarë ka materiali brenda përpara se të flisni dhe do t'ju sugjeroja pak kujdes me termat dhe gjërat që thoni pasi nuk jeni në një diskutim në kafene, jemi në mbledhjen e këshillit të bashkisë, të gjithë ne këtu përfaqësojmë dicka. Po ta kishit lexuar me kujdes materialin shumë prej këtyre pyetjeve nuk do i kishit bërë sepse e kanë përgjigjen brenda. Për shembull pyetja e parë thotë pse nuk na është paraqitur projekti teknik bashkë me kostot dhe përfitimet. Po ta lexosh marrëveshjen e para njëherë nuk ju kërkojmë që të miratoni dhe të më autorizoni mua si kryetar bashkie që të firmos marrëveshjen me 3 aktorë të tjerë të bashkisë që janë të gjithë aktorë institucionesh shtetërore. Nuk e di ku e lexuat këtë pjesë që ne po ja kalojmë pronën investitores strategjik. Ku e gjetët këtë, ku është investitori strategjik? Ma gjej në material. Jemi mbledhur për të miratuar marrëveshjen e bashkisë Korçë me 3 aktorët e tjerë, po ta lexoni marrëveshjen në detyrimet e palëve shikoni që kush janë detyrimet e secilës prej këtyre palëve në realizimin e këtij projekti . Ministria e Arsimit ka pjesën e kuadrit ligjor kryesisht, Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit ka përputhshmërinë me rregullat e urbanistikës, planin e përgjithshëm vendor të bashkisë së Korçës dhe të gjithë kuadrin që lidhet me urbanistikën, Bashkia Korçë ka detyrën të verë në dispozicion pronën dhe po i përgjigjem edhe pyetjes tjetër, prona ngelet prona e bashkisë në këto moment pasi realizimi i këtij projekti shumëmadhor do të kalojë në disa faza. Këtu jemi në fazën e dytë do të thoja unë, është bërë konkursi është zgjedhur projekt ideja dhe tani do ecim me elaburimin e kësaj projekt ideje deri në zbatim. Këtu jemi në fazën e dytë, prona do të ngelet prona e bashkisë. Detyra e bashkisë është që të japë pëlqimin njëherë që po në këtë pronë. Këtu tani keni mundësinë dhe kohën që të listoni të gjithë ato idetë tuaja. Klajdi tha që mirë do ishte që stadiumi të kishte një pistë. Dikush tjetër tha një ide tjetër. Që nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes jeni të lirë ju dhe kushdo tjetër të na i paraqesë kërkesat ne si bashki, ne ti shqyrtojmë dhe t'ja çojmë Fondit Shqiptar të Zhvillimit i cili është aktori i cili do të ketë peshën kryesore në zhvillimin e këtij projekti si dhe në ndjekjen e hapave të tjera deri në finalizimin e projektit dhe i shihni detyrimet e secilës nga palët në marrëveshje. Për të erdhur në pyetja e parë nuk është se kemi projekt teknik kosto dhe gjëra të tjera që lidhen me projektin e zbatimit. Për momentin kemi projekt-idenë pas nënshkrimit të marrëveshjes ndërmjet të 4 aktorëve do të ulemi dhe hapi i radhës është që të hartojë planin e zhvillimit të këtij projekti, të bëjë studimin e fizibilitetit , të shohë se kush do jenë palët që do të përfshihen në këtë projekt palë shtetërore apo private që do të bëhen pjesë e investimit, por ne në këtë moment nuk e kemi këtë gjë dhe nuk mund të flasim sikur do të ketë investitor strategjik sepse mund të jetë një variant që e investon komplet Fondi. Kot po them si shembull, në këtë moment ne nuk e dimë se nuk jemi akoma në plan zhvillimi të këtij projekti. Bëhet fjalë për një projekt madhor me vlerë shumë të madhe financiare. Projekti parashikon jo vetëm ndërtimin e stadiumit por edhe zhvillimin në zonën e stadiumit , por edhe krijimin sic e kemi thënë edhe në fushatë. Projekti synon ti japë qytetit një pol të ri të zhvillimit dhe ky nuk arrihet vetëm me ndërtimin e stadiumit por arrihet edhe me zhvillimin e gjithë zonës rreth stadiumit. Pra nuk kemi projekt teknik kosto dhe përfitime financiare në këtë moment. Përsa i takon pronarëve të stadiumit tani ne po vemë në dispozicion të këtij projekti 3 prona me numra pasurie që ju i keni në material të cilat sot që flasim janë pronë e bashkisë Korçë. Tani përse këto prona janë me emrin e bashkisë dhe jo në emër të dikujt tjetër kjo është një gjë që nuk zgjidhet këtu. Kemi 3 prona që janë të bashkisë që ne kemi jo vetëm detyrimin por edhe të drejtën që ti zhvillojmë në të mirë të qytetit të Korçës. Në rast se ka pretendime pronësie nga ish pronarë ata janë të lirë ti ndjekin këto pretendime në rrugët që parashikon ligji. Për tu kthyer dhe

njëherë në fillim besoj se biem dakord të gjithë që projekti i stadiumit është një projekt madhor që do i gjithë qyteti i Korçës. Mësa di unë njerëzit e kanë ëndërr këtë stadium. Po flasim për një projekt madhor dhe shqyr kemi suportin e qeverisë që e ka futur në planet e saj këtë projekt. Njëra nga pyetjet ishte në lidhje me prioritetet madhore të komunitetit dhe qytetit pse të mos bëhet një spital po të bëhet një stadium? Unë mendoj që të dyja duhet të bëhen. Ju e keni parë vet që janë bërë disa investime shumë të rëndësishme në spitalin e Korçës, këtu po jap disa shpjegime që nuk kanë lidhje me bashkinë, pra nuk është detyrë e drejtpërdrejtë e bashkisë investimet në infrastrukturën e spitaleve por patjetër që jemi palë interesi. Pra nuk është se në spitalin e Korçës nuk ka pasur investime, si në të gjithë infrastrukturën spitalore në Shqipëri është investuar në disa godina, është investuar në disa pajisje si rezonanca magnetike është nga më të mirat në Shqipëri. Në dijeninë time nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë është plan që të bëhet investim madhor në infrastrukturën e spitalit, në godinat e mbetura në spitalin. Janë disa sfida, godina pajisjet, personeli etj. Duhet investuar në të dyja paralele dhe në shumë fusha të tjera. Për pjesën e atletikës ka qënë njëri prej diskutimeve që është bërë dhe në juri, projekt ideja nuk parashikon pistë atletike me idenë që qyteti i Korçës e ka një pistë atletike tek zona sportive, ndërkohë nga informacioni që morra edhe nga anëtarët e jurisë besoj se biem dakord e keni parë edhe vetë të gjitha stadiumet e reja që bëhen kudo nëpër botë janë stadione pa pistë atletike sepse krijojnë tjetër atmosferë për ndeshjet e futbollit. Me organizimin e konkursit është marrë Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit e cila është një strukturë e cila ka shumë përvojë në organizimin e konkurseve ndërkombëtare në Shqipëri. Ka pasur dy faza konkursi, në fazën e parë ku janë shortlistuar 3 projektet, dhe faza e dytë ndërmjet këtyre 3 projekteve u zgjodh projekt-ideja fituese. Këtë pikën e investitorit strategjik e sqarova, besoj këto ishin pikat.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit kryetar për informacionin. Kalojmë në diskutimet, kush ka mendime në lidhje me këtë pikë

Këshilltar E.Bregu: Meqënëse e ngrita si fillim pikën e parë dhe jam plotësisht dakord që kryetari i bashkisë është votuar nga qytetarët për të drejtuar bashkinë ashtu dhe si këshilltarët janë duke bërë rolin e tyre për të marrë vendime. E kemi lexuar materialin me vëmendje dhe jemi informuar dhe pyetjet që kemi bërë janë plotësisht korrekte dhe deshim një përgjigje të qartë. Mesa kuptova ju po thoni që po kërkoni nga ne këshilli që të keni ju të drejtën të vazhdoni më tej me procedurat në mënyrë të paqartë dhe pa pasur ne asnjë ide se çfarë do ndodhë , pa pasur analizë as për vlerën e investimit, pra kompetencat e këshillit bashkiak po kërkon që ti delegojmë ty si kryetar i bashkisë, kështu ishte përgjigjia mesa kuptova.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Pyetja jote është ku është projekti teknik bashkë me analizën e kostove, preventivin pse nuk na është vënë në dispozicion, dhe përgjigjen ta dhashë të thashë që në këtë fazë nuk kemi projekt teknik dhe preventiv, sepse po ta lexosh me këtë do merremi tani pasi të nënshkruajmë marrëveshjen të 4 institucionet. Fondi shqiptar në pozicionin e liderit sepse ka dhe kapacitete më të mëdha se ne , do të ecë sipas 4 pikave në momentet e zhvillimit. Zhvillimi i projektit pika 3 janë fazat: Faza e Planit të Zhvillimit, Faza e Fizibilitetit, Faza e Preventivit të Projektit dhe Faza e Vënies në Funkcion. Në secilën nga këto faza bashkisë nuk është se i hiqet e drejta që të bëjë kërkesa të ndryshme. Cila pikë e kompetencës së këshillit bashkiak po shkelet? Nuk përbën ndonjë tjetërsim prone. Për ato vendimarrje që ne jemi të detyruar në bazë të ligjit të vimë në këshillin e bashkisë, patjetër që do të vijmë. Do të ndjekim ligjin për çdo gjë. Nga ana tjetër po them që jeni të ftuar dhe të mirëpritur që çfarëdo kërkesë, vërejtje sugjerim që ju të keni në vazhdim të na i jepni dhe ne ti bëjmë pjesë të paketës sonë të kërkesave dhe komenteve që do

ja përcjellim Fondit. Nuk është qëllimi ynë që të ecim duke fshehur dicka në këtë projekt. Cdo gjë do të jetë transparente. Jam shumë i lumtur që ky projekt të realizohet sa më shpejt.

Këshilltar A.Habip: Si këshilltar por dhe si qytetar edhe si sport dashës mendoj që ky është një hap shumë i rëndësishëm, e para njëherë sepse dhe për të është votuar jo vetëm kryetari por edhe si forcë politike, mendoj që ky është një zhvillim shumë i mirë për qytetin dhe për gjithë rininë dhe qytetarinë, sepse është një investim goxha serioz dhe një hap shumë i rëndësishëm qoftë i qeverisë shqiptare apo dhe i bashkisë, kështu që mendoj që ne duhet ti japim okay-in këtij projekt vendim.

Këshilltare S.Dinellari: Një koment shumë i mirë prezantimit që i bëri kryetari projektit, është edhe nga forca jonë politike, projekti është shumë i mirë ne e vlerësojmë si projekt. Problematika e parë që u përmend disa herë është nëse vendimarrja në bashki në lidhje me këtë projekt do të centralizohet vetëm nga kryetari dhe drejtoritë përkatëse apo do të vijë përsëri në këshill dhe e dyta ajo ndoshta që Lazioni nuk arriti dot ta interpretonte sic duhet është afër pronave të bashkisë ka dhe prona të tjera private. Kur ne flasim për vlerësim të pronës së bashkisë për të ndërtuar një qëndër të tillë multi funksionale do të thotë që këto pronat e tjera private do të zhvlerësohen. Ky është një problem që ne duhet ta diskutojmë ose ndoshta së bashku edhe me pronarët që janë afër pronave që i ka bashkia të kenë një lloj diskutimi. Si do të shfrytëzohen këto pronat e tjera që janë atje.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Bëhet fjalë për prona që sot janë prona private dhe janë në afërsi të zonës ku shtrihet projekti. Shiko qyteti i Korçës ka një plan të përgjithshëm vendor e kemi të miratuar nga 2016 dhe në cdo pikë të qytetit të Korçës përfshirë dhe zonën në afërsi të zonës sportive, ai pronari privat e di se çfarë mund të ndërtohet dhe sa mund të ndërtohet në pronën e tij. E dyta nuk besoj që ndërtimi i një poli të ri në atë zonën të qytetit do të çojë në zhvlerësim të pronave në afërsi të kësaj zone, madje mund të them që e kundërta është e vërtetë. Pra zonat në afërsi të kësaj zone do të vlerësohen. Ky shqetësim mund të jetë nga pronat që janë larg por jo nga ato që janë afër. Përsa i takon vendimarrjes në bazë të ligjit po e sqaroj dhe njëherë janë të përcaktuara qartë se cilat janë ato vendimarrje të bashkisë që duhet të kalojnë për miratim në këshillin e bashkisë dhe ne nuk i jemi shmangur asnjëherë këtij detyrimi ligjor, nga ana tjetër ju si këshilltarë keni të drejtë që edhe për ato vendimarrje që nuk janë për tu kaluar në këshill ju mund të kërkonit informacion dhe të bëni kërkesë për ta futur në rendin e ditës. Nuk mund të sjell për vendimarrje dicka që nuk është në tagrin tuaj për ta miratuar, nga ana tjetër edhe unë nuk mund t'ju shmang juve gjëra që janë në kompetencën tuaj. Është e rregulluar me ligj kjo gjë. Nuk kam ndonjë gjë për t'ju fshehur. Unë jam krenar për këtë projekt.

Këshilltar E.Fejzulla: Pika tjetër që do të doja të diskutonim lidhur me zhvillimin e stadiumit është përfshirja e pallatit të sportit në këtë projekt dhe nuk e di se çfarë do të bëhet me pallatin e sportit, sepse është pjesë e projektit por nuk kemi informacion nëse do të rikonstruktohet, çfarë do të ndodhë me të.

Këshilltar K.Pllaha: Në faqen 9 të dokumentit që na është vënë në dispozicion në harta kemi një zonë Accommodation Service Area, në dijeninë timë në këshillin e kaluar bashkiak kjo pronë ka kaluar nga pronë e bashkisë në Ministrinë e Turizmit mos gaboj. Pra kjo nuk është më pronë e bashkisë Korçë.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Është jashtë 3 pronave që ne po japim.

Këshilltar K.Pllaha: Kjo pronë është shpronësuar nga bashkia Korçë me qëllim të një shërbimi publik që ishte qyteza e fëmijëve dhe nuk është përdorur për këtë qëllim mesa po kujtoj unë dhe tani po kalon në pronësi të Ministrisë së Turizmit e cila po zhvillon atje mbase dhe sipërmarrje tregëtare që mbase gjeneron të ardhura. Në momentin që gjeneron të ardhura nga një pronë që ka qënë ish pronare dhe është shpronësuar për interes publik besoj se lind e drejta për të kërkuar një lloj bashkëpronësie apo shpronësim në kushtet e tregut, kjo për çështje se qeveria shqiptare ka pasur çështje në gjykatën e të drejtave të njeriut në lidhje me ish pronarët dhe në shumicën e rasteve kanë qënë kosto që janë mbuluar nga taksapaguesit shqiptar dhe nuk dua që të rëndojë dhe një kosto tjetër nga një vendimarrje e gabuar e këshillit bashkiak.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Po e filloj nga pyetja e dytë e Klajdit, kjo pronë nuk është pjesë e materialit që po sjellim sot për miratim sepse sic e thatë dhe ju me vendimarrje të këshillit të kaluar është vënë në dispozicion të Ministrisë së Turizmit për zhvillim të projektit turistik. Tani për të qënë korrekt me termat në vijim të asaj ftesës që ju bëra në fillim prona është shpronësuar bashkë me disa prona të tjera në kuadrin jo të ndërtimit të qytezës së fëmijëve por të ndërtimit të zonës sportive dhe zona sportive është një zonë e madhe dhe qyteza e fëmijëve ishte nje komponent i zonës sportive që u bë në vendin ku ishte sipas masterplanit. Tani pjesë e masterplanit të zonës sportive ka qënë edhe ndërtimi i një hoteli që kur është miratuar masterplani. Kemi pasur kërkesë nga ministria e Turizmit për ta vënë në dispozicion të një projekti strategjik të turizmit, e kemi bërë diskutim gjatë e gjërë me këshillin e kaluar në momentin që kemi bërë vendimarrjen me këtë gjë dhe ajo ideja jonë edhe mendimi ynë ka qënë po ja vlen që ne si bashki ta vemë në dispozicion këtë pronë në funksion të një projekti i cili do të investohet këtu do të krijohen vende pune , kështu është gjykuar, ky ka qënë propozimi i bashkisë bazuar në kërkesën e ardhur nga ministria e Turizmit dhe KB e ka miratuar. Përsa i takon kërkesave të ish pronarëve apo pronarëve jam përsëri me sqarimin që ju dhashë më përpara, ne nuk jemi institucion që merremi me zgjidhjen e këtyre kërkesave, gjithësecili që mendon që ka një të drejtë të caktuar duhet të ndjekë rrugën ligjore për realizimin e kësaj të drejte. Përsa i takon pyetjes së parë për pallatin e sportit edhe për pishinën që janë dy struktura sportive që do të kompletojnë zonën sportive të qytetit unë kam kërkuar edhe kryeministrit që në pjesën e konkursit ne të përfshinim edhe projektin e pishnës dhe të pallatit të sportit dhe këto janë edhe në projekt ide.

Këshilltare A.Taho: Në fakt po i dëgjoja të gjitha diskutimet me shumë vëmendje dhe më duket sikur kemi dalë totalisht nga ajo që jemi këtu për ta miratuar. Unë e kuptoj që ndërtimi i stadiumit pak kohë më parë për opozitën dhe për ndonjë tjetër mund të dukej që ishte e pamundur, sot jemi në hapat e parë për dicka shumë madhore për qytetin e Korçës. Nuk mendoj që ky këshill duhet të behet pengesë për nisjen e këtij procesi . Ashtu sic e shpjegoj dhe kryetari ashtu sic besoj se e përcakton dhe ligji për të gjitha pikat e tjera që këshilli duhet ti japë miratimin e tij çdo material do të silltet këtu . Nuk besoj se duhet të vazhdojë më diskutimi për çështje të tjera që nuk lidhen konkretisht me këtë pikë .

Këshilltar K.Koçibelli: Në këtu kemi një marrëveshje dhe meqënëse marrëveshja ka një bazë ligjore ne mund të flasim në lidhje me bazën ligjore dhe në përfundim të marrëveshjes këshilli bashkiak vendos mbi këto 5 pika që kemi në material. Po ti analizojmë të 5 pikat në së dyti miratojmë këtë marrëveshje sipas 10 neneve që ka kjo marrëveshje dhe së 3 i ngarkojmë kryetarit të bashkisë kompetencën për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje . Po ta lexoni me vëmendje do të kuptojmë që ne nuk i japim kompetenca të tjera kryetarit të bashkisë por vetëm për miratimin e kësaj marrëveshjeje. Pra shumica e këtyre pyetjeve që u bënë e kanë përgjigjen brenda asaj se çfarë ka ky projekt. Së dyti ne nuk është se jemi parlament dhe duhet ta diskutojmë këtë marrëveshje ,

ne thjesht votojmë. Në rast se duhet të pyesim është të pyesim cili është projekti dhe qëllimi i këtij projekti. Edhe po ti futemi në thelb ish bashkëpronarëve apo pronarëve komisioni që ka qënë atë ditë që ka vendosur projektin ka qënë një kryesi e cila ka qënë kompetente shumë dhe atje ka pasur dhe nga grupet e interesave. Unë mendoj që kjo pjesa i takon të shkuarës , ne këtu jemi për të hedhur hapin e parë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Besoj se këshilltarët janë edhe më të mirë informuar nga diskutimi juaj.

Këshilltare A.Përmeti: Unë si këshilltare dhe si qytetare e kam ndjekur dhe procesin e paraqitjes së projektit dhe ne si këshilltarë duhet të sigurohemi që ajo për të cilën bashkia është, është rritja e mirëqënies qytetare, rritja e mirëqënies dhe në fushën e sportit, krijimi i ambienteve të duhura për fëmijët për të rriturit, rritja e të ardhurave dhe çdo gjë. Po ta shikojmë qëllimin e projektit është konform është konform asaj e cila është rregullore dhe e miratuar me ligj. Ky projekt i cili unë kam qënë prezent, vërtet është një projekt i rëndësishëm , sepse përveç se do të krijojë një standart tjetër të sportit dhe ambienteve ndihmëse do të bëjë të mundur që këtu mund të vijnë edhe klubet e tjera të cilat ta shfrytëzojnë këtë ambient dhe kjo është një gjë shumë e mirë sepse ty do të jepet një mundësi për njohje dhe rritje e të ardhurave . Unë si qytetare dhe këshilltare e kësaj bashkie mendoj që kjo është një gjë pozitive dhe nuk ka asnjë gjë që lidhet me ndonjë shkelje dhe materiali është okay mesa unë kuptoj dhe njoh pjesën ligjore.

Këshilltar L.Petri: Dëgjova këtu nga parafolsit Anxhela , po thoshit që jemi jashtë teme sepse jemi në të njëjtin qytet ku po ndërtohet një kodër që quhet belvedere . Dhe me belvederen kështu është bërë dhe sot jemi përpara faktit që atje po ndërtohet një kodër.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nuk ka nevojë të bëni debate këshilltar me këshilltar. Nëse keni dicka mendim për të thënë okay, nuk do të lejoj që debati të dalë jashtë kontekstit.

Këshilltar L.Petri: Për mua është shumë interesante se si pronarët që janë atje nuk përfillen fare e para për mua është interesante se si nuk konsiderohet vlera shpirtërore e e atij stadiumi ashtu sic është, pse nuk konsiderohet një zonë tjetër ku bëhet stadiumi meqënëse z.kryetar e paska shumë mirë me qeverinë qëndrore dhe i ka siguruar 15,000,000 euro. Pse duhet që ne sot ti japim të drejtë zotit kryetar që të miratohet kjo marrëveshje kur ne jemi përpara faktit se si veprohet me rregulloret e tjera , ku në pronarët në pronat e tyre nuk mund të vendosin 1 kleçkë ndërsa në kodrën e belvederes i është dhënë e drejta që të ndërtojë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Jeni jashtë teme ju lutem.

Këshilltar L.Petri: Pse nuk u bë studimi i fizibilitetit së pari që ne të shikonim atë që po thotë kolegja dhe pastaj ne të japim të drejtën për të miratuar këtë marrëveshje.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem e diskutuam disa herë, nëse kryetari nuk ka gjë për të diskutuar më pas e hedhim në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 3

Vota ABSTENIM 3

Pika 9 e rendit të ditës.

INFORMACION "PËR KRIJIMIN E ALENCËS TË GRAVE KËSHILLTARE".

Këshilltare A.Taho: Nuk e di se sa të informuar jeni por që prej vitit 2018 në mars të këtij viti është krijuar Aleanca Kombëtare e Këshilltareve, për herë të parë kemi të bëjmë me një grupim informal dhe vullnetar me pjesëmarrjen e të gjitha grave anëtare në këshillat bashkiak pavarësisht përkatësive të tyre politike. Në vitin 2019 në mbështetjen e Projektit Bashki të Forta dhe me financimin e qeverisë Zviceriane është mundur që të jetë krijuar në të 61 bashkitë e republikës së shqipërisë kjo aleancë e cila ka një veprimtari të gjërë dhe fokusohet kryesisht në rritjen e pjesëmarrjes në politikë dhe fuqizimin e grave. Kjo aleancë ka marrë nisma shumë të rëndësishme në favor të grave sipërmarrëse, grave të zonave rurale apo dhe të grave me AK. Duke qënë se ne jemi pas zgjedhjeve të vitit 2023 dhe kemi një këshill bashkiak të konstituuar unë mendoj se është pikërisht momenti për të krijuar edhe në bashkinë e Korçë këtë aleancë. Do të kërkoja që në fund të mbledhjes me të gjitha zonjat e këshillit të qëndrojmë për të formalizuar strukturat e kësaj aleance dhe për të zgjedhur kryetaren, nënkryetaren dhe sekretaren e aleancës. Duke nisur le të themi një rrugëtim me aktivitete të ndryshme gjithmonë në ndihmë të komunitetit që përfaqësojmë. Shpresoj të kemi mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e të gjitha zonjave në këshill.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ashtu siç tha dhe Anxhela do ta formalizojmë në fund të takimit.

Pika 10 e rendit të ditës.

INFORMACION "MBI PROCESIN E ZGJEDHJES SË KRYESISË TË FSHATIT DHE KRYETARIT TË FSHATIT"

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ashtu sikurse ju jeni në dijeni të këtij procesi, pjesa më e madhe e juaja i ka ndjekur këto procese në të gjitha njësitë administrative. Në përfundim të këtij procesi unë nuk do të doja të ndalesha dhe të lexoja të gjithë informacionin që ka ardhur nëpërmjet procesverbaleve përfundimtare që ju i keni dorëzuar pranë sekretarisë. Është vënë re gjatë këtij procesi një pjesëmarrje e ulët e banorëve të fshatrave në këtë proces zgjedhor. Pjesëmarrja edhe në takimet ka qënë relativisht e ulët, sidomos e grave e cila për mua është shqetësuese. Në përgjithësi proceset janë zhvilluar pa problematika me përjashtime të vogla. Në disa prej fshatrave u konsiderua vendimi i shumicës për zgjidhjen e përfaqësuesve të tyre, në fshatrat në të cilat nuk u zhvillua ky proces zgjedhor sipas ligjit 139 2015 Për Vetëqeverisjen vendore neni 70. Ne në këtë proces ka disa fshatra të cilët nuk e kanë zgjedhur kryetarin anëtarët dhe kryesinë dhe i lind e drejta kryetarit për të bërë emërimin e kryetarëve të fshatit. Zgjedhjet janë zhvilluar në Shamoll, Kuç i Zi, i njësisë Bulgarec , në fshatin Brozovec, Mazrekë të njësisë administrative Lekas. Në fakt ka pasur një lloj përgjegjësi nga ana e këshilltarëve të angazhuar në këtë proces, por ka pasur dhe raste që këshilltarët nuk e kanë ndjekur këtë proces. Në fakt detyra juaj është të ndiqnit këto procese sipas zonave ku punonit deri në fund. Kjo pra përsa i përket informacionit në lidhje me krijimin e kryesisë dhe kryetarëve të fshatrave.

Pika 11 e rendit të ditës.

INFORMACION MBI ECURINË E REALIZIMIT TË TREGUESVE KRYESORË TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE, PËR PERIUdhËN JANAR-KORRIK 2023 (DREJTORIA E PËRGJITHSHME E FINANCËS)

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ky është thjesht një informacion , keni ndonjë pyetje?

Pika 12 e rendit të ditës.

KËRKESA –ANKESA TË QYTETARËVE

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kemi një kërkesë nga një banor i fshatit Melçan i cili ka qënë një nga kandidatët për tu zgjedhur në kryesi dhe më pas si kryetar i fshatit. Në fakt në atë fshat është ndjekur procedura e rregullt ligjore për zgjedhjen e kryesisë dhe të kryetarit. Ky pretendon që meqënëse ka marrë më shumë vota gjatë votimit për kryesinë ishte automatikisht kryetar i fshatit por në fakt këtu bie ndesh me anën ligjore sepse duhet që kryesia e zgjedhur të votojnë kryetarin. Ka pasur raste kur është bërë një lloj dakordësie mes anëtarëve të kryesisë të cilët automatikisht kanë zgjedhur kryetarin, por ligjore anëtarët e kryesisë kanë votuar për kryetarin dhe në këtë rast ky individ dhe pse kishte marrë vota më shumë nuk është zgjedhur nga kryesia. Këtu nuk ka shkelje ligjore sepse e gjithë procedura është e rregullt. Besoj të gjithë e mirëkuptoni, kjo kërkesë e tij bie poshtë.

Një kërkesë tjetër që ka ardhur nga Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN). Mbështetje për realizimin e studimit “Shoqëria civile për qeverisjen e mirë: Një ndërhyrje kombëtare që synon forcimin e kapaciteteve, fuqizimin e partneriteteve, dhe ndërgjegjësimin e publikut”

KËRKESË

E nderuar Znj. Kryetare:

Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AËEN), me mbështetjen e projektit rajonal “SMART Balkans – Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkëta në Ballkanin Perëndimor” i zbatuar në Shqipëri nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA), po realizon një studim cili ka si qëllim shqyrtimin e përfaqësimit të grave dhe burrave në politikë. Informacioni që do të grumbullohet përmes këtij studimi do të përdoret me qëllim forcimin e këshillave vendore. Përzgjedhja e këshillit tuaj është në vijimësi të studimeve të kryera në vitin 2016(fill pas zbatimit të kuotës 50%) dhe në vitin 2018, për të kuptuar dhe hedhur dritë mbi ndryshimet e situatës në 5 vite.

Ne po u drejtojmë këtë kërkesë për të kërkuar bashkëpunimin tuaj gjatë grumbullimit të të dhënave. Koordinatorët e punës në terrenplanifikojnë të ndjekin dhe regjistrojnë takimet e këshillit bashkiak për disa muaj. Ky informacion do të grumbullohet me qëllim analizimin e diskutimeve që ndodhin në këshill, për shembull, shqetësimet e komunitetit që diskutohen gjatë takimeve, mënyra si trajtohen shqetësimet nga këshilltarët, si dhe propozimet që bëhen për të adresuar shqetësimet.

Të dhënat që do të grumbullohen nuk do të ndahen me palët e treta. Informacioni do të jetë konfidencial dhe vetëm drejtuesja e studimit dhe asistentët e saj do të kenë akses në informacion. Gjatë procesit, nuk do të grumbullohet asnjë informacion rreth këshilltarëve, si emri, mosha, apo partia politike. Në përfundim të studimit, ju do të merrni një kopje të publikimit ku do të njiheni me rezultatet.

Nëse keni ndonjë pyetje apo shqetësim në lidhje me këtë studim, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni. Pra thjesht ky rrjet kërkon që të marrë pjesë në mbledhjet e KB për një periudhë gati 3-4 mujore të bëjë regjistrimet e mbledhjeve të këshillit dhe më pas të bëjë përpunimin e të dhënave. Në fakt unë mendoj që përderisa mbledhjet e këshillit janë online me zë më figurë s'ka pse prezenca fizike e palëve të tjera të jenë në sallë. Ka ndonjë mendim nga ana juaj, sepse në fund do kthejmë një përgjigje.

Këshilltar E.Bregu: Nëse duan të rregjistrojnë mund të rregjistrojnë nga zona ku rrinë qytetarët.

Këshilltare S.Dinellari: Po qëllim në vetvete të këtij lloj studimi kemi.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Në atë sa unë kuptova është që cila është pjesëmarrja ose diskutimet e grave ose burrave. Po ju le kohë për ti kthyer përgjigje. Diçka tjetër keni?

Këshilltar K.Pllaha: Meqënëse ishim tek kërkesat e qytetarëve kam dy kërkesa nga qytetarë Korçarë që do të doja ti vija në vëmendje të këshillit dhe ekzekutivit të bashkisë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Këtë kisha në mendje nëse ju vijnë juve kërkesa si këshilltarë është mirë që të administrohen nga sekretaria që në këtë mënyrë ne ti bëjmë publike.

Këshilltar K.Pllaha: Mund ti parashtroj sot dhe përgjigjet ti marr në mbledhjen e rradhës? Mund ta thoni dhe sot .

Këshilltare A.Përmeti: Rregullorja e ka që ne si këshilltarë duhet ta adresojmë me shkrim çdo lloj kërkesë përpara se të vijmë në mbledhje, kështu që nuk mund ta bëjmë tani sepse dhe ne duhet ta dimë cilat janë kërkesat dhe ankesat.

Këshilltar K.Pllaha: Kërkesë e parë besoj se kompetenca është tek ndërmarrja e punëve publike por më është sjellë shëmbull Bulevardi Gj. Kastrioti që është një arterie kryesore që lidh qëndrën me parkun rinia por besoj se mund të shtrihet dhe në rrugë të tjera. Problematika është në trotuarët që janë në disnivele dhe shumë njerëz lëvizin me karroca fëmijësh, persona me AK motorike kanë vështirësi për të ecur në këto trotuare dhe detyrohen të kryejnë qarkullimin e tyre në pjesën e rrugës duke u bërë shkak për aksidente. Kështu që besoj një kërkesë dhe pak kosto për ekzekutivin kështu që këto trotuare të bëhen të përdorshme nga qytetarët.

Këshilltare A.Përmeti: Mund ta dimë kush e ka bërë këtë kërkesë? Është një grup qytetarësh? Është me firma?

Këshilltar K.Pllaha: Jo por mund ta sjell me firma, kërkesa e dytë nis nga fakti që ka pasur një reformim të ligjit të zhurmave në korrik të këtij viti dhe nëpërmjet këtyre ndryshimeve ligjore janë shtuar disa kompetenca bashkive dhe një nga këto është jo vetëm hartëzimi i zhurmave që ne sërish e bëmë në një mbledhje online po besoj se duhet bërë një hartëzim i plotë i qytetit dhe krijimi i një plani masash për administrimin e zhurmave sidomos që në disa zona gjatë periudhës së verës janë bërë shqetësuese për qytetarët. Besoj se duhet të merren disa masa nga ekzekutivi për të menaxhuara këto konform ligjit.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Për pjesën e rampave qëndron si shqetësim dhe si kërkesë. Ne kemi ndërhyrë në disa rrugë që të kenë rampa kalimi , bulevardi republika dhe në disa rrugë të tjera ndërsa tek bulevardi Gjergj Kastrioti jo se është një kërkesë e re por është pak e vështirë nga ana teknike për ta zgjidhur pasi disnivele në disa kryqëzime është shumë i madh dhe këto rampat do të duhet të kishin një gjatësi shumë të madhe dhe të mos kthehen në një problem në periudhën e

ngricave dhe dëborës , megjithatë do ta shikojmë si kërkesë, të shohim se cila është mundësi më e mirë. Përsa i takon ligjit të zhurmave ai nuk është ligj i ri, janë disa ndryshime që i janë bërë ligjit ekzistues. Ato bëjnë një rishpërndarje të detyrave ndërmjet institucioneve që duhet të merren, kuptohet që do një farë kohe që ligji të kuptohet nga të gjitha institucionet dhe do kohë për tu zbatuar. Është dicka që do marrë kohë. Akoma nuk e di se cilët janë ata specialistë që mund të më asistojnë mua për të bërë një ligj të tillë sepse janë eksperiencia të reja. Ajo që unë mund t'ju them është që detyrat e bashkisë janë të bëjë këtë planin realizimin e zhurmës të caktojë orare për zona të caktuara dhe të mbikqyrë pastaj zbatimin e këtij plani , zhurmat që nuk janë zhurmë e muzikës. Zhurma e muzikës është kompetencë e policisë së shtetit që të ndjekë zbatimin e ligjit. Nga ana tjetër kjo pjesa e nivelit të zhurmës e cila duhet të jetë sipas përcaktimeve të ligjit dhe në interpretimin që i bëjmë ne këtij ligji të ndryshuar nuk është kompetenca jonë për të përcaktuar nivelin e zhurmës. Është një VKM që përcakton sa është niveli i zhurmës.

Këshilltar K.Pllaha: Besoj se është detyrë e bashkisë që të bëjë kontrollin.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Sapo ta shpejgova është kompetenca e policisë së shtetit. Si problematika qëndrojnë dhe besoj se do të zgjidhen me kohë.

Këshilltar K.Koçibelli: Për ta sqaruar këtë të zhurmës , ligji është vetëm për ato subjekte të cilat janë të rregjistruar ndërsa ka një vepër penale që është prishja e qetësisë publike që po ta shohësh të gjithë ata individë e bëjnë këtë kundravajtje penale. Të gjithë ata që e prishin qetësinë publike dënohen penalisht dhe nga ana e prokurorisë ka pasur mënyra të ndryshme procedimi, disa e kanë konsideruar vepër disa jo. Edhe kodi penal nuk është se e ka strikt këtë pjesën e prishjes së qetësisë publike, duhet parë edhe një interpretim nga kodi penal. Do të dojë kohë edhe kjo ndoshta.

Kryetari i bashkisë S.Filo: Kjo pjesa e muzikës meqënëse u hap si diskutim është një çështje ku dhe ne mes jemi mes dy zjarreve dhe duhet të mbrojmë interesin e qytetarëve ku kanë të drejtë të mos shqetësohen nga ana tjetër edhe duhet të shohim edhe perspektivën e nevojave të turizmit që ka qyteti pasi nuk mund ta zbresim këtë pjesën e jetës së natës. Prandaj dhe propozimet tona do të jenë shumë të kujdesshme që të mbajmë një balancë ndërmjet këtyre dy kërkesave ndërmjet këtyre dy grupeve.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi

KRYETARI
ANA VERUSHI